

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nuk ka paqe në Lindjen e Mesme, shtyhet takimi mes Iranit dhe Omanit, rriten çmimet e naftës
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/bota/nuk-ka-paqe-ne-lindjen-e-mesme-shtyhet-takimi-mes-iranit-dhe-om-i1185055
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 16:31:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:24:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ab1f535b7e0818d34ef730cc0df6826db343003ded20e4fc0478d624909b2500
TEKSTI	9408ee11bbdbb19087061452300ed324e28e9da9d0c7c08d35b7623fc72371d6
PAMJA	b04121660756d35ebb5d257c7518c1a04d330d8cf4d36633bcfe9cd3802b946b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4ebeae7eec0046aa3bd58a58c17ae9528aadcc11217077147b9f58ed9ddb2dd0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4ebeae7eec0046aa3bd58a58c17ae9528aadcc11217077147b9f58ed9ddb2dd0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nuk ka paqe në Lindjen e Mesme, shtyhet takimi mes Iranit dhe Omanit, rriten çmimet e naftës

Nga Erjon Dervishi
14 Shtator 2026, 18:24 | Bota



Shtetet e Gjirit Persik kanë shtyrë një takim të rëndësishëm me Iranin mbi menaxhimin e Ngushticës së Hormuzit për shkak të mungesës së konsensusit, duke penguar përpjekjet rajonale për të ulur tensionet mbi këtë rrugë ujore jetësore.

Takimi i ministrave të jashtëm ishte planifikuar për të hënë në Oman, ku Irani dhe fqinjët e tij arabë pritej të diskutonin një marrëveshje midis Teheranit dhe Muskatit për të menaxhuar përkohësisht transportin detar përmes ngushticës.

Irani ka bllokuar transportin detar përmes rrugës ujore që kur SHBA-të dhe Izraeli nisën luftën e tyre kundër Republikës Islamike në shkurt, duke e shndërruar atë në një fushëbetejë kryesore në konflikt. Çmimet e naftës u rritën pas njoftimit të shtyrjes.

Drejtori i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme për çështjet e Gjirit Persik njoftoi se takimi i ministrave të jashtëm të shteteve bregdetare të Gjirit Persik është shtyrë. Mohammad Ali Bak deklaroi se, me kërkesë të disa vendeve të rajonit dhe me një vendim të përbashkët të Omanit dhe Iranit, takimi i ministrave të jashtëm të shteteve bregdetare të Gjirit Persik, i cili ishte planifikuar për të hënë, është shtyrë për një datë të mëvonshme.

Ai nuk dha detaje të mëtejshme. Takimi do të kishte qenë hera e parë që diplomatët më të lartë nga gjashtë anëtarët e Këshillit të Bashkëpunimit të Gjirit - Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kuvajti, Katari, Omani dhe Bahreini - do të uleshin si grup me homologun e tyre iranian në pothuajse dy vjet.

Pritej që të merrte pjesë edhe Iraku. Por Bahreini, i cili mban presidencën e rradhës të GCC-së dhe ka qenë ndër shtetet e Gjirit më të goditura nga sulmet hakmarrëse të Iranit, tha të shtunën se nuk do të merrte pjesë.

Shtyrja vjen gjithashtu në një kohë kur Arabia Saudite përballet me një krizë në rritje, pas një sulmi me dron të enjten nga Iraku - ku janë aktive milicëtë shiite të mbështetura nga Irani - e detyruan atë të mbyllë një tubacion që shkon nga bregu i saj lindor i pasur me naftë në bregun e saj perëndimor. Tubacioni është bërë jetik për eksportet e naftës saudite që kur Irani mbylli trafikun përmes Ngushticës së Hormuzit.

Çmimi i naftës së papërpunuar Brent, standardi ndërkombëtar i naftës, u rrit me 3.5% në më shumë se 108 dollarë për fuçi, ndërsa tregtia u hap në Azi të hënë pas shtyrjes së bisedimeve. Më vonë ajo hoqi dorë nga disa nga fitimet e saj. **(A2 Televizion)**

TE FUNDIT

Paralajmërimi amerikan për 16 shtatorin, ambasada thirrje qytetarëve: Mos shkoni në punë, as shkolla

“UÇK, e certifikuar nga NATO”, nis dialogu i brendshëm për vlerat e vërteta të luftës çlirimtare

Alarmi fals për bombë në shkollën “Emin Duraku”, reagon Kociu: Çmenduri kriminale

Unanimitet për trupat në Gaza, “dezertojnë” Kuvendin ministri dhe krerët e Shtabit të Ushtrisë

MË TË VIZITUARAT

Paga e magjistratëve në Kuvend, Braçe i kërkon Kuvendit të kallëzojë KLP e KL...

10 qytetet që rrezikojnë të zhduken deri në vitin 2050

Hall me bord e hall pa bord! Nafta drejt 230 lekë për litër, qeveria rri duar...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Mosmarrëveshja tregtare me Trump, Kanadaja kërkon një "aleancë unike" me BE



Përshkallëzohet situata në Liban, sulmet izraelite vrasin 13 persona, mes tyre 6 fëmijë



Sinjal për Rusinë? Gjermania çon deri në 1,000 ushtarë në Lituani



Nafta mbi 107 dollarë për fuçi, tensionet në Hormuz rrisin shqetësimet



Trump, mesazh për Zelenskin: Ndal sulmet ndaj rafinerive ruse të naftës



Shpëtojnë për mrekulli zyrtarët europianë, droni rus godet trenin pranë kufirit polak: Kërcënim serioz

Latest Videos



Nga Festa per lirine e ism-ildereve te UÇK te skenaret e Serbisë me radikalët. VENDIMI jepet...

6 vite ne paraburgim kush i kompeson? Elezi: Nuk eshte parashikuar kjo gjë, nuk ka konpesim për...



Elezi: Kemi shumë raste ku prokuroria ka kërkuar shumë vite burg, por nuk është e thënë që gjykata..



Elezi: Vendimi duhet të jetë për pafajësi, maksimumi të premtën ata do jenë në Prishtinë

Shqiptëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulio
Imagjinatë
Dëshmi



A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.